



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 3378/ Prot.

Tiranë, më 19.08.2023

NJOFTIM

Në zbatim të Rregullores së Maturës Shtetërore, maturantët/kandidatët që kanë dhënë provimet e MSH 2023, sesioni i dytë, kanë të drejtë të kërkojnë rivlerësimin e provimeve, pas përfundimit të të 4 (katër) provimeve të MSH.

Maturanti/kandidati, pasi është pajisur me fotokopjen e testit ka të drejtë të paraqesë kërkesën për rivlerësim testi, në KSHIMSH e shkollës ku është regjistruar si maturant, më datë **08.09.2023**.